**MONTREAL: SHQIPËRIA MERR PJESË NË ASAMBLENË E ORGANIZATËS BOTËRORE TË AVIACIONIT CIVIL** Përgjatë datave 24 Shtator - 4 Tetor u mbajt Asambleja e Organizatës Botërore të Aviacionit në Montreal... faqe 2-3

**SPANJA PRET TAKIMIN E 68-TË VEROR TË DREJTORËVE TË PËRGJITHSHËM:** Drejtorët e Përgjithshëm të ECAC, së bashku me Komisionin Evropian, EASA-n, u mblodhën në Malaga... faqe 4

TETOR 2019 - Botimi XVI

# posta ajrore

Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar
www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al
Tel: +355 4 22 51 220

RAPORTI

## PERFOMANCA E KOMPANIVE AJRORE PËR PERIUDHËN JANAR 2018 - GUSHT 2019

faqe 8

AKTIVITETE

## AAC MERR PJESË NË SIMPOZIUMIN GLOBAL TË SIGURISË NË AVIACION

AAC mori pjesë në Simpoziumin Global të Sigurisë në Aviacion, i cili u zhvillua përgjatë datave 18 - 20 Shtator, në qytetin e Montrealit, në Kanada...

faqe 6

TË FUNDIT

## SLLOVENI: ADRIA AIRWAYS SHPALL FALIMENTIN

Pas deklaratës zyrtare nga kompania Adria Airways, për pezullimin e përkohshëm të fluturimeve, të kompanisë sllovene në të gjitha bazat e saj (Lubjanë, Prishtinë, Tiranë), Autoriteti i Aviacionit Civil, reagoi menjëherë fillimisht duke informuar pasagjerët e prekur nga kjo ngjarje mbi asistencën...

faqe 7

# AIR ALBANIA
# NIS FLUTURIMET "MIGJENI"

Pas "Lasgushit", që mbulon Stambollin, u ngrit në qiell më 30 shtator, avioni i dytë i flotës së Air Albania, nën emrin e poetit të madh "Migjeni", një Boeing 737 800, prodhim i vitit 2016, i cili do të ofrojë standardet më të larta të shërbimit për pasagjerët...

faqe 5

# MONTREAL: SHQIPËRIA MERR PJESË NË ASAMBLENË E ORGANIZATËS BOTËRORE TË AVIACIONIT CIVIL

Këtë vit, u mbajt në zyrat e saj qëndrore në Montreal, Asambleja e Organizatës Botërore të Aviacionit Civil (ICAO), përgjatë datave 24 Shtator deri më 4 Tetor. Në këtë event të rëndësishëm të aviacionit botëror, ku marrin pjesë 193 shtete anëtare të organizatës, ngjarje e cila ndodh një herë në tre vite, mori pjesë edhe Shqipëria, me delegacionin e saj nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

ICAO është agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara, ku diskutohen çështjet më të rëndësishme të aviacionit, sigurisë dhe politikat që do të ndiqen në vitet në vazhdim. Në Asamblenë e 40-të të saj morën pjesë, Drejtori Ekzekutiv i AAC-së Z. Krislen Keri dhe Koordinatori Kombëtar i ICAO-s Znj. Megi Xharo.

Asambleja u çel me fjalime nga shtete të ndryshme, për rëndësinë e pjesëmarrjes në këtë takim dhe prioritetet për vitet në vijim, ku ndër më kryesoret ishte prioriteti europian mbi çështjet e mbrojtjes së mjedisit, sigurisë kibernetike dhe iniciativa "No Country Left Behind" (Asnjë vend nuk lihet pas).

Drejtori i AAC së Shqipërisë, z. Krislen Keri gjatë takimit në zyrat qëndrore të Asamblesë së Organizatës Botërore të Aviacionit Civil, në Montreal, Canada

Në Komisionin Ekonomik Z. Keri mori fjalën për të folur mbi të drejtat e pasagjerëve dhe specifikisht në fjalën e tij theksoi se:

"Shqipëria e mbështet plotësisht dokumentin mbi mbrojtjen e pasagjerëve dhe jemi veçanërisht të vëmendshëm ndaj motorit kryesor të aviacionit civil, që janë pasagjerët.

Gjatë takimit që u zhvillua në zyrat e Asamblesë së Organizatës Botërore të Aviacionit Civil, në Montreal, Canada

**DREJTORI I AAC THIRRJE VENDEVE TË ICAO-S: DUHET TË FILLOJMË TË THJESHTËSOJMË SHKËMBIMIN E EKSPERIENCAVE DHE PRAKTIKAVE TË MIRA NË APLIKIMIN E PARIMEVE KRYESORE PËR MBROJTJEN E PASAGJERËVE**

Rritja eksponenciale e volumit të transportit ajror në botë gjatë dekadave të fundit, ka bërë të mundur, që operatorët ajror të jenë të ekspozuar ndaj skenarëve që prekin eksperiencën e pasagjerëve. Ne jemi të bindur, se mekanizmi aktual në këtë fushë delikate nuk është i mjaftueshëm dhe i bëjmë thirrje vendeve të ICAO-s, të fillojnë të thjeshtësojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira në aplikimin e parimeve kryesore për mbrojtjen e konsumatorëve për një sistem monitorimi më produktiv. Duke marrë shkas nga dinamika e industrisë, çdo ngjarje që prek të drejtat e pasagjerëve harrohet shpejt, pasi nuk ka materializim mbi mësimet, ndaj kërkohet një sistem monitorimi më i përshtatshëm.

# MONTREAL: SHQIPËRIA MERR PJESË NË ASAMBLENË E ORGANIZATËS BOTËRORE TË AVIACIONIT CIVIL

Në fushat e tjera të mbikëqyrjeve teknike, ne kemi kaluar në mbikëqyrje e bazuar në performancë dhe ne besojmë se kjo qasje mund të përshtatet në aktivitetet rregullatore drejt praktikave operacionale që prekin pasagjerin. Shqipëria e mbështet këtë qasje si një hap drejt përmirësimit të kësaj zone gri, si një mënyrë të përmirësimit të reputacionit të transportit ajror në sytë e përdoruesit final, pasagjerit."

Në komisionin e Sigurisë, përparësi ju dha sigurisë kibernetike dhe në komisionin ekzekutiv, në të cilën u trajtua dhe çështje me rëndësi si mbrojtja e mjedisit materializuar përmes nismës CORSIA, u zhvilluan debate të rëndësishme kryesisht në favor.Shqipëria u radhit mes vendeve pro nismës për të mbrojtur mjedisin dhe për të vijuar me punën e mirë bërë nga ICAO dhe vendet e tjera. Shqipëria ka hartuar një State Action Plan (Plani i Veprimit të Shtetit), të cilin e ka depozituar për zbatim. Gjatë trajtimit të diskutimeve, rëndësi ju dhe programeve audituese si USOAP dhe USAP, në të cilat u shpreh mbështetje për implementimin e tyre.

Drejtori i AAC së Shqipërisë, Z. Krislen Keri gjatë takimit në zyrat qëndrore të Asamblesë së Organizatës Botërore të Aviacionit Civil, në Montreal, Canada

Gjatë takimit që u zhvillua në zyrat e Asamblesë së Organizatës Botërore të Aviacionit Civil, në Montreal, Canada

40th TRIENNIAL ASSEMBLY
24 SEP - 04 OCT 2019

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

# SPANJA PRET TAKIMIN E 68-TË VEROR TË DREJTORËVE TË PËRGJITHSHËM: FOKUSI MBI PRIORITETET EVROPIANE DHE AMBICIET PËR ASAMBLENË E 40-TË TË ICAO

Drejtorët e Përgjithshëm të ECAC, së bashku me Komisionin Evropian, Agjencinë Evropiane të Sigurisë në Aviacion (EASA), EUROCONTROL, ICAO Zyrën EUR/NAT & JAA TO, u mblodhën në Malaga, më datat 29-31 Gusht, për takimin e tyre vjetor të pritur nga një vend anëtar i ECAC. Duke qenë se kjo ishte mbledhja e fundit përpara Asamblesë së 40-të të ICAO (Montreal, 24 Shtator - 4 Tetor), diskutimet strategjike u fokusuan në prioritetet Evropiane që duhet të ngrihen në arenën ndërkombëtare dhe në zgjedhjet e ardhshme të Këshillit të ICAO-s. Për këtë temë, Presidenti i ECAC, Ingrid Cherfils informoi takimin për kontaktet e saj të fundit me organizatat rajonale (ACAO, AFCAC, LACAC), dhe Salvatore Sciaçhitano, kandidatin evropian në zgjedhjet e Presidencës së Këshillit të ICAO, i cili ndau vizionin e tij për të ardhmen e ICAO. Siç është e zakonshme gjatë takimeve të DGCA, Drejtorët e Përgjithshëm dëgjuan përditësimet mbi zhvillimet e aviacionit në BE nga Pekka Henttu, DGCA Finlandë në emër të Presidencës së Bashkimit Evropian, dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Komisionit Evropian Henrik Hololei (DG MOVE), mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në EASA nga Drejtori Ekzekutiv Patrick Ky, dhe në performancën verore të ATM nga Drejtori i Përgjithshëm i EUROCONTROL Eamonn Brennan. Në ditën e fundit, Kryetari i JAA TO Alessio Quaranta dhe Drejtoresha Paula Almeida prezantuan rezultatin e aktiviteteve të fundit, iniciativave të reja dhe disa fakte dhe shifra në lidhje me organizatën e trajnimit.

**Miratimi i Rezolutës së re ECAC në ECAC / 37**

Drejtorët e Përgjithshëm të ECAC u takuan në një Sesion të Veçantë Plenar (ECAC / 37), ku

Z. Krislen Keri, Drejtor Ekzekutiv i AAC, gjatë takimit të Drejtorëve të Përgjithshëm që u zhvillua në Malaga, Spanjë më 29-31 Gusht 2019

Z. Krislen Keri, Drejtor Ekzekutiv i AAC, gjatë takimit të Drejtorëve të Përgjithshëm që u zhvillua në Malaga, Spanjë më 29-31 Gusht 2019

Sistemet e Pilotimi të Avionëve nga Distanca, një pozicion i cili aktualisht mbahet nga Raùl Medina Caballero (DGCA Spanjë). Vlen për të theksuar, se në këtë mbledhje u vendos që takimet e verës së Drejtorëve të Përgjithshëm të aviacionit civil evropian, do të mbahen në Tiranë, Gusht 2020.

# AIR ALBANIA: NIS FLUTURIMET "MIGJENI", TRE DESTINACIONE NË DITË DREJT ITALISË

Pas "Lasgushit", që mbulon Stambollin, u ngrit në qiell më 30 shtator, avioni i dytë i flotës së Air Albania, nën emrin e poetit të madh "Migjeni", i cili është një Boeing 737 800, prodhim i vitit 2016, i cili do të ofrojë standardet më të larta në udhëtim duke nisur nga trupa e stjuartëve, ushqimi në bord, por dhe si asnjëherë më parë televizor për çdo pasagjer. E certifikuar pranë Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC), sipas kërkesave të kuadrit ligjor vendas dhe direktivave të Bashkimit Europian, futja në treg e "Air Albania", veç komoditetit maksimal që të ofron një kompani ekselence, pasagjerëve ju ofrohet një alternativë më shumë, me çmimet më të lira Migjeni do të udhëtojë nga Tirana drejt destinacioneve Romë, Milano dhe Bolonja, ku çmimi i një bilete do të variojnë nga 59-69 euro me një destinacion, ndërsa biletat vajtje-ardhje janë 99 euro.

Kompania shqiptare ajrore, e krijuar në partneritet me Turkish Airlines, shumë shpejt arriti të zotërojë rreth 9% të tregut të fluturimeve drejt Stambollit dhe me shtimin e destinacioneve të reja drejt Italisë, pritet që prezenca e kompanisë në tregun e fluturimeve të rritet ndjeshëm. Shumë shpejt flotës së avionëve "Air Albania" do ti bashkohet dhe "Naimi", i cili pritet që para Vitit të Ri të ketë prezencë në të tjera destinacione europiane.

Avioni i dytë Boeing 737 800 i Air Albania nën emrin e "Migjeni" gjatë ceremonisë së mirëseardhjes në aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza"

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, znj. Belinda Balluku gjatë ceremonisë së mirëseardhjes që u zhvillua në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza".

Stafi i kabinës së "Air Albania" gjatë ceremonisë së mirëseardhjes në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza"
si dhe më poshte pamje në brendësi të avionit më të ri të "Air Albania"

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

# MONTREAL, KANADA: AAC MERR PJESË NË SIMPOZIUMIN GLOBAL TË SIGURISË NË AVIACION

Autoriteti i Aviacionit Civil, ka marrë pjesë në Simpoziumin Global të Sigurisë në Aviacion, i cili u zhvillua përgjatë datave 18 - 20 Shtator, në qytetin e Montrealit, në Kanada. Në këtë simpozium të rëndësishëm Shqipëria u përfaqësua nga drejtori i Drejtorisë së Sigurisë në Aviacion Z. Erjon Tema. Ky simpozium ofroi mundësi për Drejtuesit e lartë në Komunitetin e Sigurisë së Aviacionit, për të diskutuar rëndësinë e ndarjes së teknologjive të reja, teknikave dhe zgjidhjeve inovative duke forcuar bashkëpunimin. Theksi u vendos në bashkëpunimin për arritjen objektivave të Planit Global të Sigurisë së Aviacionit (GASeP) dhe zbatimin e Rezolutës 2309 të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara (2016). Çdo entitet i përfshirë në zbatimin e sigurisë së aviacionit duhet të kapërcejë pengesa të shumta. Mungesa e burimeve, mbështetja e pamjaftueshme e nivelit të lartë ose mungesa e informacionit specifik për kërcënimet janë vetëm disa nga sfidat që ndikojnë potencialisht në përpjekjet e Shtetit ose industrisë për të arritur objektivat e Planit Global të Sigurisë së Aviacionit (GASeP). Për të kapërcyer këto kufizime, shumë shtete dhe palë të interesuara të industrisë në të gjithë botën kanë zhvilluar praktikat më të mira që përmirësojnë dhe mbajnë masa efektive të sigurisë së aviacionit. GASeP, udhëzuesi i saj, dhe iniciativat rajonale të shoqëruara kanë nxitur një qasje në të gjithë botën për sigurinë e aviacionit që nxisin inovacionin, vënë theksin tek burimet e disponueshme dhe rregullojnë proceset.

Ky sesion diskutoi temat në lidhje me rezultatet e përparësisë së GASeP dhe ofroi mundësi për pjesëmarrje sa më të gjerë të audiencës dhe shkëmbim të zbatimit të rasteve të studimit dhe përvojave.

Temat që u përfshinë në këtë simpozium ishin:

- Ndërgjegjësimi i rrezikut
- Teknologjia dhe Inovacioni
- Mbikëqyrja dhe Sigurimi i Cilësisë
- Ndërtim kapaciteti

AVSEC 2019 siguroi një mundësi unike për pjesëmarrësit të kërkonin takime private me delegatë nga shtetet e tjera me pjesëmarrës nga aviacioni civil dhe autoritetet e aeroporteve, palët e interesuara dhe udhëheqësit e industrisë nëpërmjet Platformës së Shërbimeve të Takimeve të ICAO-s. Gjatë kësaj seance, pjesëmarrësit e panelit diskutuan përvojat e tyre në zhvillimin e vlerësimeve të përshtatura të rrezikut, krijimin dhe mbajtjen e kulturave të forta të sigurisë, zgjerimin e mekanizmave të shkëmbimit të të dhënave dhe tejkalimin e mungesës së raporteve zyrtare të inteligjencës për të përcaktuar kërcënimin.

**Pjesëmarrësit nga vendet anëtare të ICAO-s të pranishëm gjatë Simpoziumit Global të Sigurisë në Aviacion, i cili u zhvillua përgjatë datave 18 - 20 Shtator, në qytetin e Montrealit, në Kanada.**

# SLLOVENI: ADRIA AIRWAYS SHPALL FALIMENTIN

Pas deklaratës zyrtare nga kompania Adria Airways, për pezullimin e përkohshëm të fluturimeve, të kompanisë sllovene në të gjitha bazat e saj (Lubjanë, Prishtinë, Tiranë), Autoriteti i Aviacionit Civil, reagoi menjëherë fillimisht duke informuar pasagjerët e prekur nga kjo ngjarje duke i dhënë të gjithë asistencën e nevojshme për ndjekjen e hapave të mëtejshëm.
Kompania e cila prej kohësh kishte hasur vështirësi financiare, njoftoi pak mbas mesnatës së 23 shtatorit, se po ndalonte përkohësisht fluturimet, si pasojë e pasigurisë aktuale për të siguruar të ardhura, që kompania ajrore ka nevojë për të vijuar operimin e mëtejshëm të fluturimeve.
Fillimisht kompania u zotua se po kërkonte investitorë të mundshëm për zgjidhjen e krizës financiare, me premtimin se do të fluturonte sërish dhe se ndërprerja e operimeve është me të vërtetë e përkohshme. Përpos kësaj, stafi i AAC, nuk u ndal në asnjë moment të jepte asistencën e duhur pasagjerëve që parashikonin të udhëtonin me kompaninë, e cila mori duke mbrojtur pasagjerët, të cilët përgjatë periudhës së pezullimit fluturuan me kompani të tjera. Drejtori Ekzekutiv i AAC, z. Krislen Keri, nga takimi i zhvilluar me përfaqësues të autoriteteve sllovene, gjatë punimeve të asamblesë së 40-[të] të ICAO, mori angazhimin maksimal për informimin rreth kompanisë. Duke qenë se "Adria Airways" është kompani sllovene, përgjegjësia për licensimin dhe monitorimin e saj është e autoriteteve sllovene, ndërsa për sa i

Avion i flotës së Adria Airways, Airbus A319-132 Adria Airways S5-AAR

përket të drejtave të trafikut për të operuar nga/për aeroportin e Tiranës, i jepen të gjithë kompanive evropiane pa përjashtim.
Një javë pas pezullimit të fluturimeve, në datën 30 shtator 2019, Adria Airways njoftoi se ka dorëzuar dokumentet për procedurën e falimentimit në Gjykatën e Rrethit Kranj, Sllloveni. Gjykata e rrethit Kranj, me vendim, ref. Nr. St 2704/2019 e datës 10/02/2019, filloi procedurat e falimentimit ndaj debitorit: Adria Airways, Sllovenia Airlines.
Në mesazhin e fundit të saj, kompania sllovene deklaroi se: "Ishte kënaqësi dhe nder për ne që udhëtuat për gati 60 vite dhe u kthyet në shtëpi me ne. Faleminderit që ndatë qiellin me ne!




Tabela informative në aeroportin e Ljubljanës "Joze Pucnik" tregon fluturime të anulluara të operatorit ajror "Adria Airways"

# RAPORTI I PERFORMANCËS:

## PERFOMANCA E KOMPANIVE AJRORE PËR PERIUDHËN JANAR 2018 - GUSHT 2019

Në bazë të të dhënave të regjistruara nga Sektori i të Drejtave të Pasagjerëve në Autoritetin e Aviacionit Civil, për periudhën Janar 2018 – Gusht 2019 rezulton se performanca e disa kompanive ajrore për sa i përket vonesave, anulimeve dhe kompensimeve ka qenë si më poshtë:

✈ **ERNEST SPA** gjatë vitit 2018 ka pësuar 88 vonesa dhe anulime, ndërsa për sa i përket periudhës Janar - Gusht 2019 rezulton të jetë reduktuar në 62. Sa i përket ankesave për periudhën Janar 2018 – Gusht 2019, ato kapin shifrën prej 1573 ankesa, 731 prej të cilave janë mbyllur me kompensim dhe 165 janë në proces shqyrtimi.

✈ **BLUE PANORAMA** për vitin 2018 ka pasur 89 vonesa dhe anulime, ndërsa gjatë periudhës Janar - Gusht 2019 ky numër është reduktuar në 25. Ankesat ndaj kësaj kompanie nga pasagjerët përgjatë periudhës Janar 2018 - Gusht 2019 janë, 1616 ankesa, 656 prej të cilave janë mbyllur me kompensim dhe 772 janë në proces shqyrtimi.

✈ **WIZZ AIR** gjatë vitit 2018 rezulton me 8 vonesa, ndërsa për periudhën Janar - Gusht 2019 vonesat kapin shifrën 9. Ankesat ndaj kësaj kompanie nga pasagjerët përgjatë periudhës Janar 2018 - Gusht 2019 kapin shifrën 178, ku 62 prej të cilave janë mbyllur me kompensim dhe 21 janë në proces shqyrtimi.

✈ **ALBAWINGS** për vitin 2018 rezulton me 44 vonesa dhe anulime, për periudhën Janar - Gusht 2019, anulime nuk ka pasur, ndërsa numri vonesave është reduktuar në 4. Ankesat ndaj

kësaj kompanie nga pasagjerët përgjatë periudhës Janar 2018 - Gusht 2019 kapin shifrën prej 271 ankesa, ku 81 prej të cilave janë mbyllur me kompensim.

✈ **AIR SERBIA** për vitin 2018 ka pësuar 4 vonesa dhe anulime, ndërsa për periudhën Janar - Gusht 2019 ky numër është reduktuar në 3 të tilla. Ankesat ndaj kësaj kompanie nga pasagjerët përgjatë periudhës Janar 2018 - Gusht 2019 kapin shifrën prej 22 ankesa, 14 prej të cilave janë mbyllur me kompensim.

✈ **AUSTRIAN AIRLINES** për vitin 2018 rezulton me 6 numri i vonesave dhe anulimeve, ku për periudhën Janar - Gusht 2019 ky numër është reduktuar në 5. Ankesat ndaj kësaj kompanie nga pasagjerët përgjatë periudhës Janar 2018 - Gusht 2019 kapin shifrën prej 15 ankesa, ku 12 prej të cilave janë mbyllur me kompensim.

☝ AAC i bën thirrje të gjithë pasagjerëve që kanë plotësuar formularët e ankimimit dhe ka kaluar afati prej 6 javësh, që të rikontaktojnë përsëri kompanitë ajrore që kanë patur fluturimin për tu njohur me statusin e fluturimit të tyre. Në rast se kompania nuk i kthen asnjë përgjigje, atëherë të kontaktojnë me sektorin e të Drejtave të Pasagjerit të AAC-së në numrat e telefonit: ☏ **+355 42 381 959 / +355 44 539 959** ose me email tek: **pax@acaa.gov.al** dhe do të marrin asistencën e nevojshme. Për më shumë informacion vizitoni gjithashtu dhe linkun e mëposhtëm:

**www.aac.gov.al/te-drejtat-e-pasagjerit**




# ANALIZA STATISTIKORE

## TË DHËNAT PËR NUMRIN E PASAGJERËVE GJATË MUAJIT GUSHT

**GUSHT 2019:** Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil nga Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza", shifrat tregojnë një numër prej 425,162 pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Gusht për/nga TIA, nga të cilët 78,637 janë pasagjerë te fluturimeve Charter. Bazuar në të dhënat e mëposhtme, në muajin Gusht 2019 fluturimet charter janë ato që zotërojnë tregun me 78,637 pasagjerë dhe 18% të totalit, pasuar kjo nga 15% të kompanisë "Blue Panorama" dhe shifrës prej 64,611 pasagjerë. Shumë pranë këtyre shifrave është edhe kompania Ernest S.p.a e cila zotëron tregun me 60,561 pasagjerë ose 14% ndaj totalit *Grafiku i mëposhtëm pasqyron më qartë fluksin e pasagjerëve që kanë udhëtuar përgjatë muajit Gusht 2019, të ndarë sipas kompanive ajrore në përqindje.*




**Grafiku 1:**
**zotërimi i tregut të numrit të pasagjerëve në %, sipas kompanive ajrore që kanë udhëtuar për/nga TIA gjatë muajit Gusht 2019**

**PËRQINDJET:** Sikurse mund të shihet edhe tek grafiku, kompanitë që fluturojnë drejt Italisë, si Albawings, Blue Panorama, Ernest S.p.A, Alitalia, zotërojnë përqindjen më të madhe në tregun e transportit ajror për muajin Gusht 2019, me një numër pasagjerësh prej 190,519 dhe 45% të totalit. Këtyre shifrave shumë shpejt do ti shtohet edhe numri i pasagjerëve që do të zgjedhin të udhëtojnë drejt destinacioneve të Italisë me kompaninë Air Albania. Për sa i përket fluturimeve charter, pjesë e kalkulimit nuk është numri prej 7,438 pasagjerë i kompanisë Pegasus Airlines e cila kryen fluturime charter drejt Antalyas. Pra sëbashku totali i numrit të pasagjerëve për fluturimet charter është edhe më i lartë, duke zotëruar kështu 20% të tregut me një shifër prej 86,075 pasagjerë.

# ANALIZA STATISTIKORE

**GUSHT 2018** Nëse do të bënim krahasimin e tre viteve të fundit, trafiku ajror dhe fluksi i pasagjerëve këtë vit, gjatë Gushtit ka një rritje prej 13% krahasuar me vitin e kaluar.

**Tabela 1:**
**Numri i pasagjerëve për muajin Gusht përgjatë viteve 2017, 2018, 2019**

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL




| | Gusht 2017 | Gusht 2018 | Gusht 2019 |
|---|---|---|---|
| Shuma | 270,795 | 295,747 | 346,525 |
| Charter | 47,835 | 79,311 | 78,637 |
| Total | 318,630 | 375,058 | 425,162 |

Përsa i përket rritjes/rënies së fluksit të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Gusht 2017-2018-2019, vëmë re se rritjen më të lartë në treg e ka kompania Wizz Air, me 167%, krahasimisht me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Duke u pasuar nga Lufthansa e cila shënon rritje prej 89% të numrit të pasagjerëve krahasimisht me një vit më parë. Grafiku i mëposhtëm paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve në muajin Gusht 2019 kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018 dhe 2017:




| | Adria Airways | Alitalia | Austrian Airlines | British Airways | Jetairfly | Lufthansa | Aegean Airlines | Turkish Airlines | Air Albania | Pegasus Airlines | Blue Panorama | Air Serbia | Albawings | Volotea | Ernest Airlines | Transavia | Wizz Air | Mistral Air | Edelweiss | Pegasus Airlines (ayt) | Transavia (TO) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2017 | 16140 | 31993 | 18271 | 8774 | 4419 | 5459 | 9143 | 17168 | | 17150 | 67175 | 5709 | 19000 | 1777 | 28350 | 8999 | 3236 | 8032 | | | |
| 2018 | 13526 | 26118 | 17043 | 10649 | 4877 | 6141 | 10115 | 20365 | | 18002 | 65215 | 5435 | 40,092 | 2724 | 41639 | 4549 | 9257 | - | | | |
| 2019 | 16131 | 25235 | 18760 | 11364 | 5893 | 11627 | 13058 | 7453 | 14011 | 8945 | 64611 | 5131 | 40112 | 0 | 60561 | 4149 | 24675 | | 2392 | 7438 | 4979 |

**Grafiku 2:**
**Numri i pasagjerëve për muajin Gusht përkatësisht sipas viteve 2017, 2018, 2019 sipas operatorëve ajrorë.**

# PROJEKTI "ON CLOUD NINE": TAKIMI I TRETË I PROJEKTIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Takimi i tretë i projektit të bashkëpunimit ndërkombëtar "On Cloud Nine" – Lidhja e destinacioneve të afërta dhe të pa eksploruara me shërbime të reja interadriatike", financuar nga Programi INTERREG IPA Italy-Albania-Montenegro 2014-2020, u mbajt në Rajonin e Molises, Campobasso, Itali në datat 25 -26 Shtator 2019. Gjatë takimit, Lideri i projektit, Aeroportet e Puglias S.p.A dhe partnerët e tjerë: JSC tAeroporti i Malit të Zi, Rajoni Molise dhe Autoriteti i Aviacionit Civil, diskutuan mbi progresin e aktiviteteve të projektit dhe mbi identifikimin dhe implementimin e fluturimeve direkte, falë edhe zhvillimit të transportit inter-modal i cili mundëson lidhjen përmes transportit me autobus të Rajonit të Molises me Aeroportet e Puglias S.p.A. Në vijim, partnerët ranë dakord mbi hapat e mëtejshme për zbatimin e aktiviteteve të ardhshme të projektit dhe përgjegjësitë që ka secili partner. Projekti "On Cloud Nine", financohet në kuadër të Aksit 4 të Programit INTERREG IPA Italy-Albania-Montenegro 2014-2020 "Rritja e aksesibilitetit ndërkufitar, promovimi i shërbimeve të qëndrueshme të transportit si dhe fasilitetet dhe përmirësimi i infrastrukturës publike". Ky projekt ka për qëllim krijimin e lidhjeve të reja ndërmjet Pulias dhe Shqipërisë si dhe Pulias dhe Malit të Zi, përmes testimit të rrugëve te reja ajrore Brindisi - Tirana dhe Brindisi - Podgorica.

Gjatë Takimit të tretë të projektit të bashkëpunimit "On Cloud Nine" zhvilluar në Rajonin e Molise, Campobasso në Itali.



Pjesëmarrësit gjatë Takimit të tretë të projektit të bashkëpunimit "On Cloud Nine" zhvilluar në Rajonin e Molise, Campobasso në Itali.

Interreg - IPA CBC
Italy - Albania - Montenegro
EUROPEAN UNION
ON CLOUD NINE

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL